

Hyrje

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka si mision krijimin dhe zhvillimin e një mjedisi akademik që nxit mirëkuptimin dhe ndërveprimin ndërkulturor në shoqëri. Gjithashtu nxit bashkëpunimin akademik me institucionet homologe dhe bashkëpunimin me ato qeveritare, organizata profesionale, si edhe komunitetet lokale për ndërveprimin në shoqëri dhe promovimin e shkëmbimeve gjuhësore, akademike e kulturore. Një nga misionet kryesore të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja është edhe promovimi i gjithëpërfshirjes për studentët me aftësi ndryshe. Ky planifikim strategjik përcakton vizionin, misionin dhe qëllimet e ardhshme të Fakultetit në kuadër të gjithëpërfshirjes së studentëve me aftësi ndryshe.

Qëllimi i këtij plani është koordinimi i aktiviteteve dhe nxitja e sistemit arsimor gjithëpërfshirës i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimin gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë studentëve duke kontribuar në mirëqënien personale të tyre.

Pranë Fakultetit janë të regjistruar pesë studentë me aftësi ndryshe, përkatësisht tre studentë me dëmtim ortopedik, një student me paaftësi në shikim dhe një student tetraplegjik. Klima gjithëpërfshirëse në Fakultet ndihmon në krijimin e një mjedisi universitar që është i favorshëm për zhvillimin psiko-social të studentëve.

Duke u mbështetur në Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025 të hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, parashtrijmë këto qëllime dhe objektiva:

Qëllimi 1.

Realizimi i aksesueshmërisë në mjedisin e Fakultetit për studentët me aftësi ndryshe.

Një nga politikat më të rëndësishme është ajo e sigurimit të aksesueshmërisë fizike në të gjitha mjediset dhe shërbimet për të gjithë studentët.

Qëllimi, objektivat specifike dhe strategjitë e parashikuara në këtë plan për realizimin e aksesueshmërisë, adresojnë reduktimin e barrierave për studentët me aftësi ndryshe me qëllim:

- Përfshirjen dhe pjesëmarrjen në jetën studentore.
- Ndryshimet në sjellje të cilat diskriminojnë studentët me aftësi ndryshe.

Objektivi specifik 1

Realizimi i aksesueshmërisë në mjediset e Fakultetit për studentët me aftësi ndryshe.

Objektivi specifik 2

Realizimi i aksesueshmërisë në informacion dhe në komunikim me strukturat e Fakultetit për studentët me aftësi ndryshe.

Objektivi specifik 1. Realizimi i aksesueshmërisë në mjediset e Fakultetit për studentët me aftësi të ndryshe.

Disa strategji të cilat e përmbushin këtë objektiv janë :

1. Vendosja e rampave të jashtme.
2. Montimi i një karrigeje elektrike që do të shërbejë për të transportuar studentët paraplegjik dhe tetraplegjik.
3. Ndërtimi i një ashensori të jashtëm.
4. Pajisja me një shirit me relief paralajmërues të shkallëve.
5. Pajisja e auditorëve me banka të përshtatura për studentët me paaftësi fizike.

Objektivi specifik 2. Realizimi i aksesueshmërisë në informacion dhe në komunikim me strukturat e Fakultetit për studentët me aftësi ndryshe.

Realizimi i këtij objektivi mund të arrihet nëpërmjet :

1. Komunikimit me Sekretarinë Mësimore, Sekretarët e Departamenteve dhe struktura të tjera të Fakultetit nëpërmjet E-mail-it zyrtar.
2. Informimit të studentëve nëpërmjet platformës Teams nga profesorët e lëndëve.

Qëllimi 2.

Njohja e studentëve me kërkesat e tregut të punës.

Për zbatimin e këtij qëllimi , Fakulteti i Gjuhëve të Huaja do të fokusohet në dy objektiva specifike:

Objektivi specifik 1	Bashkëpunimi me institucione arsimore publike dhe jo publike, Agjensi përkthimi dhe Agjensi Turistike.
Objektivi specifik 2	Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve që synojnë nxitjen e integritit të studentëve me aftësi ndryshe në tregun e punës.
Objektivi specifik 3	Pajisja e studentëve me aftësi që kërkohen sot në tregun e punës.

Objektivi specifik 1. Bashkëpunimi me biznese dhe kompani të ndryshme me të cilat Fakulteti ka marrëveshje.

1. Promovimi i rasteve të punësimit pas përfundimit të studimeve për të nxitur vazhdimësinë e tyre.
2. Ofrimi i punëve vullnetare për studentët me aftësi ndryshe pranë zyrave të Fakultetit me qëllim krijimin e marrëdhënieve ndërpersonale dhe njohjen me mjediset e punës.
3. Pjesëmarrja e studentëve me aftësi ndryshe në ALUMNI FGJH në mënyrë që ata të mbajnë lidhjet me Fakultetin.

Objektivi specifik 2. Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve që synojnë nxitjen e integritit të studentëve me aftësi ndryshe në tregun e punës.

1. Bashkëpunimi me AKPA (Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive) për të informuar studentët me AK për programet e praktikave profesionale, por edhe me punëdhënësit për promovimin e punësimit të studentëve me aftësi ndryshe që përfundojnë studimet e larta.
2. Bashkëpunimi me kompani të ndryshme private të cilat ofrojnë mundësi punësimi për studentët me aftësi ndryshe.
3. Bashkëpunimi me institucione të ndryshme që ofrojnë trajnime, intershipe apo mundësi punësimi për studentët me aftësi ndryshe.

Qëllimi 3.

Sigurimi i arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës për studentët me aftësi ndryshe.

Lidhur me realizimin e të drejtës për të patur akses në arsimin gjithëpërfshirës të studentëve me aftësi ndryshe duhen:

- Materiale të aksesueshme dhe të përshtatura për llojet e aftësive ndryshe.
- Kurrikula gjithëpërfshirëse për të ofruar mbështetje dhe përshtatje të individualizuar.

Objektivi specifik 1	Rritja e mundësive për pjesëmarrje në arsimin gjithëpërfshirës për studentët me aftësi ndryshe.
Objektivi specifik 2	Trajnimi i stafit akademik.

Objektivi specifik 1. Rritja e mundësive për pjesëmarrje në arsimin gjithëpërfshirës për studentët me aftësi ndryshe.

1. Zbatimi i Planit Edukativ Individual (PEI) , i hartuar nga komisionet multidisiplinare të vlerësimit të nevojave arsimore për studentët me aftësi ndryshe.
2. Ofrimi i materialeve akademike të personalizuara të cilat mund të kuptohen dhe përdoren lehtë nga kategori të ndryshme të personave me aftësi ndryshe.
3. Bashkëpunimi me komisionet e vlerësimit, sipas modelit të gjithëpërfshirjes dhe monitorimi sistematik i ecurisë së studentit në procesin akademik.
4. Vlerësimi i nevojave për materiale didaktike dhe planifikimi i buxheteve për sigurimin e tyre sipas kërkesave specifike të kategorive të ndryshme të studentëve me aftësi ndryshe.

Objektivi specifik 2. Trajnimi i stafit akademik.

1. Trajnime për mësimdhënien e studentëve me aftësi ndryshe.
2. Trajnime lidhur me planin PEI (Plan Edukimi Individual)

Qëllimi 4.

Garantimi i përfshirjes së studentëve me aftësi ndryshe në jetën studentore.

Objektivi specifik 1

Sensibilizimi i të gjithë studentëve lidhur me gjithëpërfshirjen në Fakultet.

Objektivi specifik 2

Rritja e përfshirjes së studentëve me aftësi ndryshe në aktivitete të organizuara nga Fakulteti.

Objektivi specifik 1. Sensibilizimi i të gjithë studentëve lidhur me gjithëpërfshirjen në Fakultet.

1. Realizimi i fushatave sensibilizuese me qëllim që studentët të ndërgjegjësohen dhe informohen rreth sfidave me të cilat studentët me aftësi ndryshe përballen.
2. Organizimi i leksioneve të hapura për të gjithë studentët me qëllim informimin e tyre më të detajuar lidhur me aftësitë ndryshe.

Objektivi specifik 2. Rritja e përfshirjes së studentëve me aftësi ndryshe në aktivitete të organizuara nga Fakulteti.

1. Pjesëmarrje në shkollat verore.
2. Pjesëmarrje në klube studentore.
3. Pjesëmarrje në projekte të ndryshme.
4. Ofrimi i seancave të meditimit.
5. Pjesëmarrje në leksione të hapura.

Qëllimet dhe strategjitë e hartuara synojnë finalizimin e këtij plani për studentët me aftësi ndryshe. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja inspiron çdo ditë e më shumë projekte dhe bashkëpunime gjithëpërfshirëse në dobi të studentëve dhe strukturave të tij. Bashkëveprimi dhe të qenurit gjithmonë në koherencë me njëri-tjetrin, promovon unitetin e Fakultetit.